

SOLIDARITET ME PENSIONISTËT



Të gjithë pensionistët në vend do të shpërblehen me 3 mijë lekë për pensionist me rastin e festeve të fundvitit. Kjo bëhet e mundur në bazë të vendimit të marrë nga Këshilli i Ministrave, duke mbajtur kështu zotimin për solidaritet me këtë shtresë të popullsisë. Vendimi u bë i ditur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, e cila informoi se përfitues do të jenë rreth 663 227 qytetarë, nga të cilët: mbi 530 364 janë pensionistë në pension pleqërie; 67 754 janë në pension invaliditeti; 49 849 janë në pension familjar; dhe mbi 13 260 persona të tjerë janë në trajtim financiar me pension social, pension apo trajtim të veçantë financiar si minatorë të nëntokës, punonjës të ish-ndërmarrjeve ushtarake dhe ushtarakë në pension të parakohshëm.

PRIORITETET E BUXHETIT 2020



Buxheti i shtetit për vitin 2020 fokusohet në Rindërtim dhe Investime në vazhdimësi për qytetarët. Kështu u shpreh Ministria e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj, gjatë një konference për mediat ku foli për zhvillimet e fundit kryesore ekonomike në vend. Ministria u shpreh se Buxheti 2020 synon uljen e Borxhit në nivelin prej 64.8% të PBB; deficit brenda Parametrave të Vendosur me një Bilanc të Përgjithshëm prej 2.2% të PBB; Investime Publike në nivelin jo më pak se 4.55% PBB-së; Bilanc Primar Pozitiv në nivelin prej 0.1% të PBB. "Fokus i Buxhetit 2020 do të jetë në çdo rast ofrimi i shërbimeve dhe realizimit të prioriteteve tona strategjike, me synimin për të sjellë impakt të prekshëm", u shpreh Ministria.

RRITJA EKONOMIKE TREMUJORE



Rritja ekonomike për tremujorin e tretë të vitit 2019 rezultoi të jetë 3.81%, sipas INSTAT. Performanca e ekonomisë gjatë tremujorit të tretë shkoi në linjë me performancën e tregut të punës gjatë këtij tremujori, ku norma e papunësisë njohu sërish një reduktim të konsiderueshëm, ndërkohë që nga pikëpamja e kërkesës agregate bie në sy një rritje prej 3.9% e konsumit final të popullatës. Ndërkohë, Investimet e Huaja Direkte janë rritur me 7.3% për 9-mujorin e vitit 2019, duke arritur nivelin e 810 milionë eurove. Fondamentet kyç të ekonomisë mbeten mjaft të forta dhe disa prej tyre me përmirësim të konsiderueshëm, si indeksi i besimit të konsumatorit, rritja e kreditimit të konsumatorëve apo rritja e punësimit dhe nivelit të pagave.

SIGURIA E LODRAVE



Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka vijuar gjatë kësaj periudhe kontrollet në tregun e lodrave dhe të produkteve për fëmijë. Inspektime u kryen në tregun e "Medresesë" në kryeqytet, në subjekte importuese, si dhe ato të tregtisë me shumicë dhe pakicë, ku disa prej subjekteve tregtonin produkte që nuk plotësojnë standardet europiane, pra janë të pamarkuara CE dhe me mungesë të dokumentacionit teknik, të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi. ISHMT, në bashkëpunim me Qendrën Konsumatori Shqiptar, ka kryer teste laboratorike për disa modele lodrash të marra në analizë dhe ka rezultuar se ka elementë kimikë me rrezik të lartë për shëndetin e fëmijëve. Vetëm në ditët e para të muajit dhjetor, ISHMT ka bllokuar rreth 10 mijë produkte, pasi tregtoreshin në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

LEHTËSITË TATIMORE PËR RINDËRTIMIN



Në funksion të përballimit të pasojave të krijuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore të 26 nëntorit, qeveria ka parashikuar disa lehtësi fiskale për tatimpaguesit. Një nga këto lehtësi lidhet me pagesën e tatimit mbi vlerën e shtuar. Sipas ndryshimeve të bëra në ligjin përkatës, përjashtohen nga detyrimi për të paguar TVSH shtëpitë e gatshme të importuara, materialet, komponentët dhe pajisjet që do sillen për ndërtimin e banesave (tulla, beton, hekur etj.) dhe që do të gjenden në situacionimin e punimeve, në kuadër të Programit të Rindërtimit.

CERTIFIKIMI I AUDITUESVE NË SEKTORIN PUBLIK



Ministria e Financave dhe Ekonomisë zhvilloi ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik për sezonin 2018-2019. E pranishme në aktivitet, Ministria Denaj foli mbi rëndësinë e rolit të audituesve në administrimin me efektivitet dhe përgjegjshmëri të financave publike, si dhe të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve mbi mënyrën se si menaxhohen financat publike. Ministria theksoi nevojën e ridinamizimit të mënyrës së auditimit në sektorin publik, sipas standardeve ndërkombëtare, çka kërkon më shumë llogaridhënie dhe kualifikim. Procesi i certifikimit përfundoi me dhënien e certifikatës së "Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik" për 41 persona.

PUNËSIMI ME NDËRMJETËSIMIN E ZYRAVE TË PUNËS



1735 persona janë punësuar në të gjithë vendin me ndërmjetësimin e Zyrrave të Punës gjatë periudhës 1-26 dhjetor 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me 469 persona, ndjekur nga qarku i Durrësit me 217 persona, qarku i Fierit me 216 persona, qarku i Vlorës me 149 persona, qarku i Elbasanit me 132 persona, qarku i Korçës 128 persona, qarku i Shkodrës me 123 persona, qarku i Gjirokastrës me 84 persona, etj.